



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria për Arsim

05.Nr.311/18

Datë: 01.08.2018

Drejtoria për Arsim në Komunën e Istogut dukë u bazuar në neni 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe në mbështetje të: UA-MPMS, Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, UA-MASHT, nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, si dhe UA-MASHT, nr.02/2017 Për Vlefshmerinë e Programeve Studimore të Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës/e, viti shkollor 2018/2019

Shfmu "Bajram Curri" Istog

1. Një mësimdhënës/e për nivelin (1-5) zëvendësim deri sa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonis, paralelja e ndarë Cërrc.

Shfmu "Hysni Zajmi" Vrellë

1. Një Mësimdhënës/e Mbështetës/e për fëmijet më nevoja të veqanta në paralelen e ndarë Prigodë, zëvendësim derisa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

Shfmu "Martin Camaj" Gurrakoc

1. Një mësimdhënës/e për gjuhë Gjermane, me normë të plotë në 3 shkolla dhe atë "Martin Camaj" Gurrakoc, "Ismail Qemail" Staradran dhe "Avni Rustem" Zallq.

Shfmu "Trepça" Banjë

1. Një mësimdhënës/e për gjuhë Angleze në (gjuhën boshnjake) vend i lirë i punës.
2. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane me normë të plotë në 5 shkolla të mesme të ulta dhe atë në "Trepça" Banjë, "Zymer Zeka" Kaliqan, Tre "deshmoret" Uçë. "Ndre Mjeda" Rakosh dhe "Mehmet Akifi" në Shushicë.

Shfmu "Avni Rustemi" Zallq

1. Dy mësimdhënës/e për nivelin (1-5) klasë të kombinuara, paralelja e ndarë në Kosh.

Shfmu "Zymer Zeka" Kaliqan

1. Një mësimdhënës/e për nivelin (1-5) zëvendësim deri sa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonis.
2. Një edukatore për parafillor, zëvendësim deri sa puntorja të kthehet nga pushimi i lehonis.

Shfmu "Tre Deshmoret" Uçë

1. Një mësimdhënës/e për nivelin (1-5) në paralelen e ndarë Cërkolez, vend i lirë i punës.

Shfmu "Mehmet Akifi" Shushicë

1. Një mësimdhënës/e për nivelin (1-5) paralelja e ndarë Shushicë e Ultë, vend i lirë i punës.

Shfmu "Fan S.Noli" Llukac i Begut

1. Një mësimdhënës/e të mesimit klasor (1-5) (në gjuhën shqipe) vendi i lirë i punës nga data 24.09.2018.
2. Një mësimdhënës/e për Kimi (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë, Dobrushë dhe Banjë.
3. Një mësimdhënës/e për Histori dhe Edukat Qytetare (në gjuhën boshnjake), në Dobrushë dhe Banjë.
4. Një mësimdhënës për Biologji (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë në Dobrushë dhe Banjë.

Gjimnazi "Haxhi Zeka" Istog

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Frënge normë e plotë vend i lirë i punës.
2. Një mësimdhënës/e për lëndën Filozofi Sociologji vend i lirë ,norma jo e plotë 12 orë.

Ndërsa për vendet e punës Mësimdhënës/e Mbështetës/e për fëmijet më nevoja të veqanta kandidateve sipas nenit 7 të Normativit Nr.10/2018 u kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- 1.Niveli Master arsimit gjithëpërfshirës apo arsimit me nevoja të veqanta ose
- 2.Fakulteti filozofik dega e pedagogjisë ose
3. Fakulteti filozofik dega e pedagogjisë speciale ose
- 4.Fakulteti i edukimit programi i arsimit fillor

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Çertifikata e lindjes
- Kopja e diplomës e vërtetuar, ose certifikata në vend të diplomës e vërtetuar jo me e vjetër se gjashtë muaj gjdo certifikat me e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasyshë.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet ti kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime ,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

Afati i konkursit mbetet i hapur prej datës 01.08.2018 deri më datën 15.08.2018.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100,kati përdhësë dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës po në të njëjten zyrë.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje,Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit i njeiti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit(kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim dhe intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të udhëzimit administrativ të MASHT-Nr.10/2018.Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Gjatë përzgjedhjes,në kushte të barabarta, përparësi do të kenë ata mësimdhënës që pa fajin e tyre kanë mbet pa vendë pune në ndonjërin nga shkollat e komunës së Istogut duke patur gjithmonë parasysh kriterin e përgatitjes profesionale.

Drejtori i DKA-së
Hajrush Shoshi

